

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mohammed bin Salman i kërkoi Trumpit të godasë Houthit, SHBA refuzoi përfshirjen direkte
ADRESA	https://piranjat.al/bota/mohammed-bin-salman-i-kerkoi-trumpit-te-godase-houthit-shba-refuzoi-perfshi-i103723
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 18:11:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 18:10:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	acfada25168b5f2e2814b5c4648523d75a14cfc03106833c25672987f8c1f0ff
TEKSTI	401d3bf72be6e5cc882a1bc00087286e5c97b819b5552419e0d98919f30aa3a4
PAMJA	1153a6226774f99bc35c33d588366b757428ea13c987e5e278e6948ae2c86eeb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4a49f2613295d35691e517725c7c65f0159adb0705b85e57be975535938f57f3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	648cf5643b7eec9631eeb9308ec676d258ca5b066518a7d2fcbfc98479d63336
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4a49f2613295d35691e517725c7c65f0159adb0705b85e57be975535938f57f3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **ne nje mobilizim afatoiatë** çdo mbremje në Tiranë ■ **Greqise, DEA dhe policia** e personave të arrestuar ■ **shqiptar qe ra në kurthin e** shpërndares droge në Minnesota u arrestua ■ **pamjartueshem** ■ **e akuzuar si dorositës** përgendrohen në botën e trafikut të

BOTA

Mohammed bin Salman i kërkoi Trumpit të godasë Houthit, SHBA refuzoi përfshirjen direkte

Piranjat Përditësimi i fundit 11 Shtator 2026, 20:10



Princi i Kurorës së Arabisë Saudite, Mohammed bin Salman, i kërkoi dy herë presidentit amerikan Donald Trump që Shtetet e Bashkuara të ndërmarrin sulme kundër Houthive në Jemen, ndërsa grupi i mbështetur nga Irani po afrohet me një prej pikave më strategjike të Detit të Kuq.

Sipas dy zyrtarëve amerikanë të cituar nga Axios, MBS telefonoi Trumpin dy herë gjatë së enjtes. Në bisedat telefonike, ai e informoi presidentin amerikan për përkeqësimin e situatës në Jemen dhe më pas i kërkoi që SHBA-ja të ndërhynte ushtarakisht kundër pozicioneve të Houthive.

Trump, megjithatë, e refuzoi kërkesën. Zyrtarët amerikanë theksuan se administrata nuk ka aktualisht plane për një ndërhyrje të drejtpërdrejtë ushtarake kundër Houthive.

Situata është përshkallëzuar pasi forcat Houthi morën kontrollin e një qyteti strategjik bregdetar në Jemen, duke iu afruar më shumë ngushticës së Bab al-Mandabit.

Bab al-Mandab është një prej korridoreve më të rëndësishme detare në botë dhe lidh Detin e Kuq me Gjirin e Adenit. Kontrolli ose kërcënimi ndaj kësaj zone mund të ndikojë drejtpërdrejt në tregtinë globale dhe në eksportet e naftës saudite.

Tensionet janë bërë edhe më të mëdha për shkak të situatës në Ngushticën e Hormuzit, ku Irani po pengon tashmë trafikun detar. Një kontroll më i madh i Houthive mbi Bab al-Mandabin do t'i jepte Teheranit një tjetër instrument presioni ndaj SHBA-ve dhe aleatëve të saj në Gjirin Persik.

SHBA rrit mbështetjen për Arabinë Saudite

Ndërsa Washingtoni po përpiqet të shmangë hapjen e një fronti të ri ushtarak, mbështetja ndaj Arabisë Saudite po rritet.

Komandanti i Komandës Qendrore të SHBA-ve, admiral Brad Cooper, udhëtoi të enjten drejt Arabisë Saudite për takime urgjente koordinimi, sipas burimeve të cituara nga Axios.

Një zyrtar amerikan tha se Washingtoni do t'i ofrojë Riadit informacione të inteligjencës dhe të dhëna për identifikimin e objektivave të Houthive.

Rreth 200 personel ushtarakë amerikanë ndodhen tashmë në Arabinë Saudite, ku ofrojnë mbështetje jo-luftarake.

Nga përplasja diplomatike te lufta në terren

Përplasje mes Arabisë Saudite dhe Houthive u rikthye fuqishëm në korrik, pasi Riadi pengoi një avion iranian që transportonte zyrtarë të lartë Houthi të ulej në Sana'a pas kthimit nga ceremonia mortore e ish-udhëheqësit suprem iranian Ali Khamenei.

Në atë periudhë, Mohammed bin Salman i kërkoi Trumpit mbështetje politike për një sulm ndaj aeroportit të Sana'as, duke e bërë të qartë se Arabia Saudite nuk kishte nevojë për ndihmë ushtarake amerikane. Trump e mbështeti politikisht kërkesën saudite.

Më pas, Houthit nisën sulme ndaj cisternave saudite në Detin e Kuq, duke kërcënuar një prej rrugëve kryesore të eksportit të naftës së mbretërisë. Sulmet u zgjeruan më vonë edhe ndaj objekteve energjetike saudite.

Arabia Saudite dhe aleatët e saj jemenas iu përgjigjën me sulme ajrore dhe operacione tokësore kundër pozicioneve të Houthive.

Riadi kërkon gjithnjë e më shumë ndihmën amerikane

Kërkesa e fundit e MBS për ndërhyrje direkte amerikane shënon një ndryshim të rëndësishëm në qëndrimin e Arabisë Saudite.

Në korrik, Riadi i kishte komunikuar Washingtonit se mund ta përballonte vetë kërcënimin Houthi. Përshkallëzimi i luftimeve dhe përparimi i forcave Houthi kanë bërë që Arabia Saudite të kërkojë një nivel gjithnjë e më të madh mbështetjeje nga SHBA-të.

Zyrtarët amerikanë dhe sauditë kanë diskutuar javët e fundit për situatën, ndërsa Washingtoni ka përsëritur se prioriteti i Trumpit është përqendrimi i forcave amerikane te Irani dhe Ngushtica e Hormuzit.

Kjo strategji synon të shmangë hapjen e një fronti të dytë ushtarak në një kohë kur tensionet me Teheranin janë tashmë të larta.

Washingtoni: Prioriteti është liria e lundrimit

Një zyrtar i lartë i administratës Trump tha se prioriteti i SHBA-ve është garantimi i lirisë së lundrimit në Detin e Kuq, ndërsa përgjegjësinë për përballjen më të gjerë me Houthit duhet ta marrin partnerët rajonale.

“SHBA-të janë të përqendruara në mbrojtjen e interesave tona thelbësore të sigurisë kombëtare, përfshirë garantimin e lirisë së lundrimit në Detin e Kuq”, deklaroi zyrtari.

Ai shtoi se Washingtoni është në dialog të vazhdueshëm me Arabinë Saudite dhe qeverinë e Yemenit për stabilitetin rajonal.

Për momentin, Trump duket se po përqipet të mbajë një vijë të mesme: të mbështesë Arabinë Saudite dhe të mbrojë korridoret strategjike të transportit, pa e përfshirë drejtpërdrejt ushtrinë amerikane në luftën kundër Houthive.

Megjithatë, përparimi i forcave Houthi drejt Bab al-Mandabit dhe përshkallëzimi i tensioneve me Iranin mund ta bëjnë gjithnjë e më të vështirë për Washingtonin të qëndrojë jashtë konfliktit.

Artikuj te sugjeruar

BOTA 11 Shtator19:55

Trump nga Pentagoni: Irani nuk do të ketë kurrë, kurrë një armë bërthamore

Donald Trump ka mbajtur një fjalim në përkujtimin e 11 shtatorit në Pentagon këtë pasdite. Presidenti amerikan i përdori kom...

BOTA 11 Shtator19:26

Meloni përshëndet suksesin e partisë së ekstremit të djathtë Alternativa për Gjermaninë

Partia e ekstremit të djathtë Alternativa për Gjermaninë (AfD) po bëhet më e fortë sepse “Koalicioni i Madh” n&eu...

BOTA 11 Shtator18:55

Autobusi me turistë del nga rruga dhe përmbysët/ 5 të vdekur dhe 40 të plagosur

Pesë persona kanë humbur jetën dhe 40 të tjerë janë plagosur pas një aksidenti të rëndë trafiku të enjten...

BOTA 11 Shtator18:31

Fjalët e para të babait të Giorgos Mazonakis pas vdekjes së tij: Kush do ta sjellë fëmijën tim përsëri tek unë?

Me zemër të thyer, babai i tij foli për herë të parë pas humbjes së Giorgos Mazonakis. Manolis Mazonakis ...

BOTA 11 Shtator18:04

Funerali i ‘papranueshëm’ i Milladiç/ Kroacia paralajmëron Serbinë për tërheqjen e mbështetjes për në BE

Kryetari i parlamentit të Kroacisë e paralajmëroi të premten Serbinë se nuk mund të mbështetet në mbështetjen e Zag...

BOTA 11 Shtator18:03

Sekretari amerikan i Luftës betohet: Do ta përfundojmë betejën me Iranin

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, është deklaruar për luftën e Iranit, gjatë ceremonisë përkujtimore të 11 s...

BOTA 11 Shtator17:56

11 shtatori/ Trump: Nuk do të harrohet kurrë! 25 vitet që pasuan treguan fuqinë e Amerikës për të triumfuar dhe fituar

Presidenti Donald Trump deklaroi të premten në Pentagon se fryma e fuqishme amerikane, e cila ka qëndruar e fortë gjatë 25 viteve q&eu...

BOTA 11 Shtator16:41

Nga president në kandidat për kryeministër, Aleksandër Vuçiç zbulon kur do të japë dorëheqjen

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, deklaroi se do të japë dorëheqjen nga posti më 25 ose 26 shtator, duke thënë&...

BOTA 11 Shtator16:13

Incidenti në avion e Easyjet/ Aeroporti i Malpensës në Milano u mbyll për një orë

Aeroporti ndërkombëtar i Malpensës në Milano u mbyll për rreth një orë mbrëmjen e të enjtes pas një incidenti ...

BOTA 11 Shtator15:36

Vdekja e këngëtarit Giorgos Mazonakis/ Arrestohen dy mjekët e klinikës greke

Dy mjekët e klinikës private në Athinë, ku humbi jetën këngëtari i njohur grek Giorgos Mazonakis, janë arrestuar nga p...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 10 Shtator

[EMRI/ Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinë...](#)

Përgjegjësia e Cristiano Mossalit për vrasjen e shqiptarit Nexhat Ramës konsiderohet e sigurt, ndërsa ajo që mbetet për tërësq...

BOTA 10 Shtator

[VIDEO/ Nëna bisedon me shogën, pak metra më tej...](#)

Ky është momenti tronditës kur një vogëlushe humb jetën pasi shtypet nga një makinë, ndërsa ajo po luante me motrë...

BOTA 11 Shtator

[Skandali "Dobson"! Si oficerja e burgut i dërgo...](#)

Një oficerë burgu në Britani ka shmangur qelinë, pasi u përfshi në një marrëdhënie intime me një të burgosur...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!



Reagon Cllevio!



Matilda,Piranjë jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.